



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE, E VERIFIKIMIT DHE INTEGRIMIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____. 2019

Të dhëna mbi Vendimin

Nr. 69, datë 09 .11.2019

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 13/3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar (në vijim "LPP"), në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "Donianna" Shpk nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimeve publike, sipas parashikimeve të nenit 13/3/a të LPP, *për keqinformim dhe dorëzim të dokumenteve, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi*, në procedurën e prokurimit me objekt: "Blerje këpucë për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve", me fond limit 27.807.583 lekë pa Tvsh të zhvilluar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (në vijim "ABP") në datë 09.05.2019.

Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa): "Donianna" Shpk me NIPT J62410005G, me adresë: Pranë Kthesës së Kamzës.

I. Arsyet e fillimit të procedimit administrativ:

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "Donianna" Shpk, ka nisur mbi bazën e kërkesës Nr. 1263 Prot., datë 09.07.2019, të dërguar nga ABP, me të cilën kjo e fundit i propozon APP-së nisjen e hetimit administrativ ndaj operatorit ekonomik "Donianna" Shpk për përjashtimin e tij nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, në zbatim të nenit 13/3/a të LPP.

II. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e keqinformimit dhe paraqitjes së dokumentave me të dhëna të rreme, sipas parashikimeve të nenit 13/3/a të LPP.

III. Masat:

Me Vendimin Nr. 69, datë 04.11.2019, APP ka vendosur të përjashtojë për 3 (tre) vjet operatorin ekonomik "Donianna" Shpk, nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik,

nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, pasi ka vlerësuar si rënduese faktin se, shoqëria “Donianna” Shpk ka ndërhyrë në dokument me qëllim për ta paraqitur atë si dokument të vlefshëm të lëshuar nga institucioni kompetent, me qëllim kualifikimin e saj në procedurën e prokurimit të sipërcituar.